



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

KURRIKULA ME ZGJEDHJE

LËNDA: MUZIKË

KLASA: X

Tiranë, 2016



Përmbajtja e Programi

I.	Hyrje	4
II.	Korniza konceptuale e programit	6
II.1.	Qëllimet e programit të muzikës.....	9
II.2.	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës.....	10
II.3.	Lidhja e muzikës me temat ndërkurrikulare	14
II.4.	Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare	15
II.5.	Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj.....	17
II.6.	Ndarja e kohës mësimore për tematikë për secilën klasë	20
III.	Shkalla e pestë, përmbajtja	21
III.1	Tematika : Gjuha dhe komunikimi muzikor.....	22
III.2	Tematika: Teknika dhe procese muzikore	25
III.3	Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria	28
IV.	Udhëzime metodologjike	32
V.	Udhëzime për vlerësimin	34
VI.	Materiale dhe burime mësimore.....	35

Tabelat dhe diagramet

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit.....	7
Digrama 2: Rezultatet e të nxënit të komptencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës për shkallën e pestë.	12
Digrama 3: Lidhja ndërmjet muzikës dhe fushave të tjera.	16
Digrama 4 : Kompetencat e lëndës dhe tematikat e lëndës.	18
Tabela 1: Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës	19
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	20

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës dhe pjesë integrale e jetës sonë të përditshme, në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Artet dhe studimi i tyre zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: art pamor, muzikë dhe teatër të cilat lidhen ngushtë dhe ndihmojnë në zhvillimin intelektual, emocional, social dhe kulturor të nxënësve nga parashkollori deri në arsimin e mesëm të lartë.

Nëpërmjet përjetimit, vëzhgimit, krijimit, vlerësimit, artet mundësojnë dhënie kuptim ideve dhe komunikim nëpërmjet krijimeve artistike. Gjuha artistike dhe veprat e artit, të veshura me vlera sociale dhe kulturore të jetës së përditshme, kontribuojnë në zhvillimin e këtyre vlerave dhe pasqyrojnë historinë dhe shoqërinë njerëzore. Gjithashtu, artet luajnë një rol të rëndësishëm në shprehjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore të shoqërisë dhe në zhvillimin, afirmimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor dhe atij kombëtar.

Artet përfshijnë artin pamor, muzikën dhe teatrin në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm të lartë, pikërisht në *shkallën e pestë* ose në *shkallën e gjashtë*.

Kurrikula e arteve¹ në *shkallën e pestë* ose *të gjashtë* fokusohet në zgjerimin e njohurive artistike dhe zhvillimin e tyre në përdorimin dhe zbatimin e gjuhës artistike. Ato krijojnë, performojnë/realizojnë dhe vlerësojnë artet duke mundësuar gjykime dhe qëndrime të qarta në klasë, përmes dëgjimeve muzikore të autorëve të ndryshëm dhe zhvillimit historik muzikor, duke krijuar kompetenca të qëndrueshme dhe të zbatueshme në këto disiplina artistike.

¹Artet, zhvillohen në kurrikulën me zgjedhje të detyrueshme për shkallën e pestë ose të gjashtë të arsimit të mesëm të lartë përmes tri lëndëve: art pamor, muzikë dhe teatër.

I. Hyrje

Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit. Kjo tregon që muzika krijon edhe historinë e vet përmes kultivimit e sofistikimit të “këngës” primitive dhe kultivimin e përpunuar të zërit njerëzor e të instrumenteve të muzikës. Të bashkërenduara e të nënrenduara në procesin e edukimit, ato do të kërkojnë të trajtohen në mënyrë të veçantë e sistematike edhe në këtë program lëndor. Muzika është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësin të kuptojë dhe lidhë fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset, teknikat dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre, si dhe duke shpjeguar mënyrat e interpretimit dhe ndërtimit, gjë e cila çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimin të muzikës.

Vazhdimi i rrugëtimit të njohjes me muzikën është një vlerë e madhe për të mundësuar ***edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të dëgjuar në mënyrë të pavarur e sistematike vepra të ndryshme muzikore si dhe për të menduar dhe gjykuar në mënyrë kritike rreth tyre.***

Muzika është e pranishme kudo në jetën tonë të përditshme (në klasë, shtëpi, TV, film, koncert, teatër, kolonë zanore, ngjarje të shënuara familjare, veprimtari brenda dhe jashtë shkollës, ngjarje të komunitetit etj.).

Muzika nuk mund të kuptohet dhe realizohet duke marrë vetëm disa njohuri, por duke vazhduar njohjen më të plotë të saj përmes *gjuhës muzikore dhe komunikimit* nëpërmjet saj, të njohjes me veprat muzikore, *teknikat dhe proceset* nëpër të cilat zhvillohet muzika, realizuar kjo nëpërmjet dëgjimit të veprave muzikore dhe kuptimit të tyre sipas formës, gjinisë dhe stilit, *njohjes me zhvillimin kulturor dhe historik të muzikës*, njohuri që bëjnë të vetëdijshëm nxënësin për rolin e muzikës në jetën e përditshme dhe vlerësimin e saj nëpërmjet një gjuhe të saktë muzikore.

Muzika është arti që shprehet me *tinguj*, ndaj të gjitha krijimet muzikore përvetësohen me anë të dëgjimit dhe përjetohen emocionalisht dhe shpirtërisht. *Tingulli* është *mjeti shprehës*, përmes cilësive të tij zhvillohet *kohëzgjatja, lartësia, forca dhe timbri*. Kuptimi i drejtë i cilësive të tingujve dhe harmonisë së tyre në një melodi/vepër muzikore kërkon dëgjimin e kujdesshëm të veprave muzikore si dhe përjetimin e tyre.

Familjarizimi dhe përvetësimi i veprës muzikore buron nga fakti se ndikimi i saj tek dëgjuesi është i trefishtë: *shqisor, emocional dhe shpirtëror*, gjë që sjell edhe përjetimin e trefishtë. Përjetimi emocional i muzikës është i lidhur ngushtë me përjetimin shqisor, prandaj mendohet se muzika, më shumë se të gjitha artet e tjera, nxit drejtpërdrejt ndjenjat e njeriut dhe u drejtohet pikërisht atyre.

Edhe pse përjetimi shqisor dhe emocional ka forcë dhe rëndësi të madhe, për përjetimin e plotë të veprës muzikore si krijim artistik i shpirtit të njeriut, është i domosdoshëm edhe kundërveprimi shpirtëror i dëgjuesit dhe kërkohet pjesëmarrja e tij e vetëdijshme dhe aktive. Duhet ndjekur me vëmendje dhe duhet lidhur të gjithë faktorët që përbëjnë një vepër muzikore.

Bukuria e kombinimit emocional të tingujve, forma dhe konceptimi i saj si një e tërë, bën që nxënësi të kuptojë më së miri mesazhin që mbart dhe përcjell vepra muzikore. Shumë rëndësi ka koha në të cilën është krijuar vepra, autori, zhvillimi historik, politik, social kulturor, të cilat japin një panoramë më të qartë si dhe krijojnë një kuptim, duke realizuar më të plotë përjetimin shqisor, emocional dhe shpirtëror të veprës muzikore.

Lënda e muzikës synon të edukojë nxënësin nga pikëpamja estetike dhe muzikore, duke e orientuar atë në mënyrë të saktë drejt kuptimit të vlerave estetike dhe muzikore apo drejt veçorive të ligjërimit muzikor nga abstraktja te konkretja, në njohjen me gjinitë dhe llojet e ndryshme të muzikës, me mënyrat e interpretimit dhe performimit muzikor, si dhe me zhvillimin historik të muzikës në periudha, kontekste dhe kultura të ndryshme.

II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor të muzikës rrjedh nga: korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë. Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së muzikës, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit**, për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriterëve të vlerësimit në periudha të caktuara.
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi i muzikës ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të lëndës së muzikës** si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i **temave ndërkurrikulare** nëpërmjet lëndës së muzikës është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e muzikës dhe të gjitha arteve të tjera që përbëjnë fushën e arteve në shoqëri dhe në jetën e përditëshme.

Programi përmban **3 tematika** që janë të përbashkëta në të gjitha disiplinat artistike të fushës së arteve dhe krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqitet **koha mësimore për secilën tematikë**.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e muzikës me fushat e tjera në mënyrë që kurrikula e arsimit të mesëm të lartë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit artistik të nxënësve.

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie në muzikë është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik që zotëron brenda vetes. Në këtë program **vlerësimi i nxënësve** është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënësve.

Programi i përmbajtjes së muzikës paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

Qëllimet e APU

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi:

- të ndërtojë dhe të zhvillojë *njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera* që kërkon shoqëria demokratike;
- të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme;
- të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

II.1. Qëllimet e programit të muzikës

Programi i muzikës, nëpërmjet përmbajtjeve të përcaktuara sipas *tematikave* të tij, ka si qëllim zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe koncepteve për formimin muzikor, estetik dhe kulturor; zhvillimin e aftësive interpretuese dhe dëgjuese muzikore, për *të njohur, dëgjuar, përjetuar dhe vlerësuar* vepra muzikore shqiptare ku përfaqësohet trashëgimia jonë kombëtare muzikore, si dhe vepra të muzikës botërore nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore, sociale, politike dhe historike. Në programin e muzikës nxënësi mëson të zbulojë *ngjashmëritë, ndryshimet, marrëdhëniet* në muzikë, provon të performojë nëpërmjet interpretimit vokal, krahason veprat muzikore përmes dëgjimit, zhvillon më tej gjykimin dhe argumentin duke krijuar një qëndrim të vetin e duke ua paraqitur të tjerëve, edukohet të punojë në grup dhe ndihet i suksesshëm në muzikë.

Muzika si gjuhë universale dhe dëgjimi si proces i saj do të mundësojë që nxënësi të:

- përjetojë dhe vlerësojë vlerat e muzikës kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar për ta ruajtur dhe për ta kultivuar identitetin kombëtar;
- zhvillojë aftësitë e përjetimit *estetik dhe vlerësimit kritik*.
- përjetojë dhe vlerësojë muzikën e epokave të ndryshme sipas stilit, gjinive dhe llojeve muzikore, duke zhvilluar aftësitë e përfytyrimeve dhe përjetimeve muzikore mbi veprat që dëgjon;
- zhvillojë aftësitë e bashkëpunimit dhe të krijimit të raporteve ndërmjet kulturave duke ndërvepruar në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupe të ndryshme kulturore apo etnike;
- kuptojë forma të ndryshme të veprimtarisë muzikore duke zhvilluar aftësitë interpretuese, krijuese, gjykuese;
- zhvillojë kompetencat muzikore për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme muzikore, punë të pavarur, duke krijuar përmbledhje nga vepra të ndryshme muzikore shqiptare apo të botërore;
- marrë pjesë në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke vënë në shërbim të mjedisit, ku jeton, aftësitë dhe talentin e vet;
- japë kontributin personal në zhvillimet artistike muzikore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

II.2.Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për shkallën e pestë ose të gjashtë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme gjatë procesit të të nxënit.

Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Organizimi i mësimit të muzikës me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Kur nxënësi realizon kompetencat muzikore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh.: kompetenca e muzikës “Interpretimi/performimi muzikor” ka të bëjë me proceset dhe teknikat e zhvillimit të muzikës, të cilat kuptohen shumë mirë nëpërmjet dëgjimit muzikor apo interpretimit të veprave muzikore. Përmes këtij programi nxënësi në mënyrë graduale , vit pas viti, do të fillojë të njihet me zhvillimin e muzikës vokale dhe muzikës instrumentale nga gjinia më e vogël deri tek ato më të mëdhatë.

Nxënësi duhet të ketë njohuri për karakteristikat kryesore të muzikës së epokave të ndryshme dhe për artistët më të shquar që u përkasin këtyre epokave. Gjithashtu, përmes përjetimit të veprave muzikore, ai duhet të dijë t'i vlerësojë ato dhe të përvetësojë kriteret për të dalluar muzikën estetisisht të mirë dhe të vlefshme.

Nëpërmjet dëgjimeve muzikore të veprave të ndryshme vokale apo instrumentale të kompozitorëve të shquar që nga antikiteti e deri te muzika e shekullit XX dhe përjetimeve të tyre, nxënësi duhet të dallojë *stilin, formën, gjininë, interpretuesin apo ansamblin interpretues, karakteristikat e epokës* në të cilën është krijuar vepra muzikore.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave muzikore pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë. Në zhvillimin e kompetencave muzikore, nxënësi gjithashtu zhvillon kompetencat kyçe në lidhje me *krijimtarinë, interpretimin, vlerësimin* e muzikës, përpunimin e informacionit për muzikën, prezantimin e detyrave të zhvilluara rreth muzikës që dëgjon apo krijon, prezantimin e punës në grup, komunikimin efektiv etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së muzikës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi për lëndën e muzikës;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës së muzikës që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së muzikës;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave muzikore, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit për lëndën e muzikës;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për lëndën e muzikës.

Digrama 2²: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës.

SHKALLA E PESTË/GJASHTË
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë muzikore të përjetimit, dëgjimit dhe analizimit të veprave muzikore; - gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë mesazhin muzikor të veprës; - shprehet qartë dhe komunikon saktë estetikisht dhe artistikisht për vepra të ndryshme muzikore; - komunikon dhe shprehet nëpërmjet mjeteve shprehëse muzikore në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.
Kompetenca e të menduarit
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; - zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me muzikën apo artin, në jetën e përditshme apo në klasë/shkollë;

² Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe, do të përdoren pamvarësisht klasës në të cilën do të zhvillohet kjo lëndë (në klasën e 10-të, 11-të apo 12 –të).

- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese gjatë dëgjimit të një vepre muzikore;
- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim, projekt apo veprimtari muzikore artistike.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi :

- vendos njohuritë muzikore në funksion të realizimit të një argumenti, krijimi apo projekti muzikor/artistik;
- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një punë të vetën mbi artin në përgjithësi apo muzikën në veçanti;
- zhvillon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi :

- zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt artistik/muzikor;
- drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- inicion aktivitete ndërgjegjësuese ndaj ruajtjes së mjedisit, nga zhurmat akustike.

Kompetenca personale

Nxënësi :

- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerret gjatë veprimtarive muzikore/artistike;
- merr pjesë dhe kontribuon në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe komunitet;
- zhvillon vetëbesimin tek aftësitë e veta dhe krijon lirshmëri dhe besim tek të tjerët në realizimin e detyrave artistike.

Kompetenca qytetare

Nxënësi :

- promovon me qytetari vlerat të ndryshme kulturore dhe muzikore të vendit apo të krahinës;
- respekton punën dhe mendimin e të tjerëve lidhur me çështje artistike /muzikore;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

Kompetenca digjitale

Nxënësi :

- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet lidhur me aspekte të ndryshme kulturore/muzikore;
- njih e përdor mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

II.3.Lidhja e muzikës me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Muzika ka një shumëllojshmëri të veprimtarive në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë sepse jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; trashëgimia kulturore dhe iso-polifonia, të drejtat e njeriut; mjedisi dhe muzika; ndërvarësia ndaj muzikës; bashkëjetesa paqësore,etj.*, nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve të ndryshme muzikore duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grup në aktivitete të ndryshme, duke dhënë kontributin e vet, duke u dhënë zgjidhje situatave dhe problemeve të ndryshme muzikore/artistike, duke përdorur gjuhë të saktë muzikore për të komunikuar vlera dhe qëndrime, duke shpjeguar teknika dhe procese të ndryshme muzikore që lidhen dhe me fusha të tjera që ata mësojnë.

Nxënësi mëson të komunikojë dhe shprehet përmes gjuhës muzikore, duke zhvilluar më tej idetë e veta muzikore, duke organizuar krijime muzikore vetëm ose në grup, sipas elementeve të gjuhës muzikore dhe shprehur atë përmes komunikimit estetik - artistik.


Nxënësi fillon të familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave vokale muzikore, duke respektuar rregullat e interpretimit muzikor e ndarë përvojat e veta performuese me të tjerët.

Nxënësi zhvillon llogjikën e analizës së veprave muzikore, duke reflektuar dhe duke bërë një gjykim kritik dhe estetik muzikor.

II.4.Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Melodia, ritmi, harmonia, dinamika, tempi, forma, struktura etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike artin pamor dhe teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore etj. Kështu mësuesi duhet t'u japë mundësinë nxënësve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat , që ata kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të muzikës me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.

Digrama 3: Lidhja ndërmjet muzikës dhe fushave të tjera kurrikulare.



II.5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e muzikës synon të përmbushë 3 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen dhe ndërthuren me kompetencat kyçe, që një nxënës duhet të zotërojë dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore të lëndës së muzikës.

Kompetencat e lëndës:

- krijimi muzikor;
- performimi/interpretimi muzikor;
- vlerësimi i veprave muzikore.

Tematikës e lëndës:

- gjuha dhe komunikimi muzikor;
- teknikat dhe proceset muzikore;
- historia, muzika dhe shoqëria.

Digrama 4 : Kompetencat që formohen përmes tematikave




Tabela 1: Kompetencat e veçanta dhe përshkrimi i tyre

Kompetencat e veçanta	Përshkrimi i kompetencave
Krijimi muzikor.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor ide të ndryshme për të organizuar mendimin e tij personal estetiko-muzikor; - zhvillon mendimin e tij mbi elementet muzikore gjatë analizimit të veprës muzikore; - shpreh përjetimet dhe përfytyrimet muzikore gjatë dëgjimit muzikor të një vepre muzikore; - organizon njohuritë e veta për të shprehur mesazhin e veprës muzikore; - ndan përvojat e veta muzikore me të tjerët.
Interpretimi muzikor.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - performon dhe interpreton emocionalisht gjatë procesit të këndimit këngë korale dhe të rrymave të ndryshme moderne, kanone, këngë popullore, etj., duke zhvilluar një kuptim të qartë të këndimit vetëm dhe në grup; - përjeton emocionalisht gjatë procesit të dëgjimit, vepra të ndryshme muzikore (vokale apo instrumentale), duke zhvilluar një kuptim të qartë të veprës muzikore; - këndon motive apo tema mjaft të njohura të pjesëve muzikore apo melodive të përzgjedhura (rinjohje nëpërmjet fishkëllimit apo këndimit të temave kryesore); - jep gjykimin dhe mendimin e vet mbi përmbajtjet muzikore të pjesëve të

	<p>parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të tyre(ese-ja);</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë.
<p>Vlerësimi i veprave muzikore.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon gjykimin e vet muzikor dhe estetik mbi veprat të ndryshme muzikore; - analizon veprat muzikore (vokale dhe instrumentale), duke u mbështetur veçoritë e veprave muzikore; - bën krahasimin midis dy veprave muzikore, duke u shprehur me një gjuhë të qartë muzikore dhe përdorur terminologji të qartë muzikore; - vlerëson veprat muzikore, sipas llojit muzikor, autorit, vendit dhe periudhës historike në të cilën është realizuar vepra, duke ndërtuar një gjykim kritik dhe estetik.

II.6.Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Lënda e muzikës zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje të detyruar në klasën X, XI, ose XII. Në klasën X zhvillohet në 36 javë mësimore me nga 2 orë, pra gjithsej 72 orë. Programi i lëndës së muzikës specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë, ku shumica e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

Tematikat	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknikat dhe proceset	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa X,XI,ose XII	15	30	27	72 orë

III. Shkalla e pestë ose e gjashtë , përmbajtja.

Në programin e lëndës së muzikës, janë paraqitur përmbajtjet sipas tematikave të mëposhtme:

- *gjuha dhe komunikimi muzikor;*
- *teknika dhe procese muzikore;*
- *historia, muzika dhe shoqëria.*

Këto tematika plotësojnë dhe janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera në lëndën e muzikës. Ato janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit sipas kompetencave muzikore për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat me to. Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave në këtë renditje. Kombinimi, ndarja e njohurive dhe koncepteve muzikore në situata të nxëni, grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre, është e drejtë e përdoruesve të programit (mësuesve dhe autorëve të teksteve).

Për “përkthimin” e programit të shkallës në tekste mësimore apo programe lëndore, aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në tematika dhe njësi mësimore të zhvilluara logjikisht.

REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE,

SHKALLA E PESTË/GJASHTË: KLASA X,XI.XII.

III.1.Tematika : Gjuha dhe komunikimi muzikor

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Muzika dhe shumë çështje të saj trajtohen përmes studimit të *gjuhës muzikore*. Kuptimi dhe shpjegimi i gjuhës muzikore tashmë jo vetëm nëpërmjet elementeve dhe parimeve të formësimit muzikor, por edhe nëpërmjet kuptimit dhe shpjegimit emocional të veprës, zhvillon mendimin personal të nxënësit për të kuptuar të bukurën në muzikë. Gjatë dëgjimit muzikor sipas formave të interpretimit vokal apo instrumental, nxënësi kupton se muzika është e organizuar sipas formës dhe përmbajtjes. Duke i përjetuar veprat e ndryshme muzikore nëpërmjet dëgjimit, nxënësi fillon të kuptojë nga njëra anë muzikën me tipare “thjesht muzikore” dhe, nga ana tjetër, muzikën si pjesë e strukturave sintetike të artit, e përzier me letërsinë, teatrin, baletin etj. Muzika është një veprimtari tërësisht humane dhe duke qenë kështu, ajo i përket njeriut dhe botës së tij. Nga ana tjetër, ashtu si vetë njeriu, ajo mund të shfaqet në mënyra të ndryshme dhe secila prej tyre sjell në vetvete diçka origjinale.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS

Krijimi muzikor

Nxënësi/sja :

- krijon një mendim estetik rreth veçorive që e bëjnë një krijim muzikor të bukur;

- zhvillon idenë se muzika kërkon përqendrim dhe dëshirë për tu ndjekur;
- zhvillon idenë rreth të bukurës në muzikë përmes vlerësimit estetik;
- zhvillon mendimin për rëndësinë e gjuhës muzikore si mjet për të realizuar mendimin njerëzor;
- komunikon mendimin e vet për vepra të ndryshme muzikore, duke përdorur një gjuhë të saktë;
- krijon kolazhe nga vepra vokale ku dallohen shumëllojshmëri zërash dhe shpjegon ato;
- krijon kolazhe nga vepra të ndryshme instrumentale, me shumëllojshmëri instrumentesh të ndryshme dhe shpjegon punën e vet;
- ndan përvojat e veta muzikore me të tjerët.

Interpretimi muzikor

Nxënësi/sja :

- interpreton idenë e vet për një vepër të caktuar muzikore, përmes një gjuhe të saktë;
- interpreton ndikimin dhe reflektimin e kulturave tek njëra-tjetra, duke u ndalur në dy vepra konkrete;
- interpreton përjetimin e vet emocional përmes esesë, vizatimit ose fjalës, lidhur me vepra të ndryshme muzikore;
- interpreton pse –në e ndryshimit të gjendjeve emocionale gjatë dëgjimit muzikor të veprave të ndryshme muzikore, vokale apo instrumentale, sipas mendimit të vet;
- shpjegon qartë dallimin e *formës muzikore* dhe *karakterin muzikor* të veprës gjatë dëgjimit muzikor.

Vlerësimi muzikor

Nxënësi/sja :

- evidenton praninë e muzikës në jetën e përditshme dhe vlerëson atë;

- formulon ide të ndryshme rreth artit dhe muzikës, dhe shpreh mendimin e tij bazuar në bindje personale;
- vlerëson përmes përjetimit një vepër muzikore sipas formës dhe llojit muzikor.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Gjuha, mendimi dhe komunikimi muzikor:

- Muzika dhe funksionet e saj.

Elementet dhe parimet muzikore:

- Melodia, ritmi, harmonia.

Format muzikore

Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA X/XI/XII

Nxënësi/ja:

- formulon ide dhe përkufizime të ndryshme rreth artit muzikor;
- shpjegon funksionet e muzikës përgjatë zhvillimit të historisë së njerëzimit;
- diskuton rreth veçorive apo karakteristikave, që e bëjnë një krijim muzikor të bukur;
- shpjegon rolin e mjeteve *shprehëse muzikore*, bazë në kuptimin dhe realizimin e një vepre muzikore;
- përshkruan dhe diskuton mbi ndryshueshmërinë e emocionit që krijojnë *elementet muzikorë* në një vepër;
- shpjegon *parimet e formësimit të muzikës dhe kupton strukturën muzikore të ndërtimit të një vepre muzikore (formë - përmbajtje)*;
- kupton format muzikore *njëpjesëshe, dypjesëshe dhe tre pjesëshe dhe polifonike*.
- bën dallimin e tyre gjatë dëgjimit muzikor të veprave vokale dhe instrumentale.

III.2.Tematika: Teknika dhe procese muzikore

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Të kënduarit dhe instrumentet muzikore janë zhvilluar përgjatë periudhave të ndryshme muzikore, ashtu sikurse janë zhvilluar dhe krijuar forma të ndryshme dhe të reja muzikore. Këndimi ka kaluar nëpër një rrugëtim të gjatë deri në zhvillimin dhe perfeksionimin teknik të tij. Kështu nga këndimi njëzërësh dhe më pas ai shumëzërësh, filluan të krijohen forma dhe lloje muzikore të ndryshme vokale por edhe instrumentale. Interpretimi vokal i pjesëve të sugjeruara janë rrugëtimi i të kënduarit vokal solo dhe në kor, klasike dhe moderne. Pjesët muzikore vokale dhe këngët e rrymave të ndryshme muzikore do të jenë pjesë e mësimin dhe interpretimit vokal të kësaj tematike.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

Krijimi muzikor

Nxënësi/ja :

- imiton me fishkëllimë/zë ose këndon motivet apo temat mjaft të njohura të veprave muzikore vokale apo instrumentale;
- këndon saktë nga ana intonative dhe ritmike repertor të thjeshtë koral;
- sugjeron melodi të cilat krijojnë dhe përcjellin emocione gjatë leximit dhe interpretimit të një vepre letrare.

Interpretimi muzikor

Nxënësi /ja:

- interpreton këngë dhe pjesë të vogla vokale;
- përjeton emocionalisht tekstin e këngës, gjatë interpretimit vokal të tij;
- këndon vetëm dhe në grup (ansambël/kor);
- ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë.

Vlerësimi i veprave muzikore

Nxënësi/ja :

- përjeton emocionalisht këngët apo veprat vokale, të interpretuara nga këngëtarë të ndryshëm;
- kupton lidhjen e tekstit me muzikën pamvarësisht llojit të këngës;
- përjeton dhe vlerëson rëndësinë e interpretimit të pjesëve vokale, duke zhvilluar gjykimin e vet personal;
- kupton reflekton emocionet që i krijon një vepër vokale apo instrumentale muzikore gjatë interpretimit;
- gjykon një interpretim vokal përmes një eseje.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA X/XI/XII

Këndimi vetëm (solo)

Nxënësi/ja:

- njeh dhe respekton rregullat e këndimit vetëm dhe në grup;
- njeh ndërtimin dhe formacionin e plotë të korit, sipas mënyrës së vendosjes së një kori, pozicionin e koristit në mënyrën e vendosjes në kor dhe të qëndruarit gjatë këndimit;
- provon të këndojë vetëm dhe me të tjerë, duke kuptuar ndryshueshmërinë e zërit dhe ngjyrimin e tij nga të tjerët;
- dëgjon dhe komenton gjendjen emocionale që krijohet nëpërmjet timbrit të zërit të këngëtarëve me vokal të ndryshëm;
- njeh përmbajtjen poetike dhe melodike të pjesëve vokale muzikore, faktor për një interpretim dhe realizim më të mirë artistik dhe shprehës

Këndimi në grup (kor)

- gjatë këndimit;
- këndon në intonacion të pastër dhe ritëm, vetëm ose në grup pjesët vokale dhe këngët e mëposhtme:
 - *J.S.Bach-Gounod* - “*Ave Maria*”.
 - *R. Schuman* - *Nina nana*.
 - *L.V. Bethoven* - “*Oda e gëzimit*” – koralja, simfonia 9-të.
 - *S. Gjoni* - “*Lule Borë*”.
 - *R. Dhomi* - “*O moj e Bukura More*”.
 - *Këngë të rrymave të ndryshme moderne.*
 - *Fragmente nga mjuzikëll të ndryshëm.*

III.3. Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Kultura muzikore dhe zhvillimi i saj sipas karakteristikave dhe konteksteve historike, sociale dhe kulturore në të cilat ato janë zhvilluar merr përsipër të studiojë zhvillimin e saj të veprave dhe kompozitorëve, nga *Antikiteti* e deri në ditët tona përmes disa periudhave. *Periudha e Mesjetës* na njeh me korin gregorian, muzikën polifonike, instrumentet muzikore, jetën dhe veprat e kompozitorëve të kësaj periudhe. Ajo vazhdon më tej me zhvillimin e muzikës në periudhën e Rilindjes, si dhe me zhvillimin e formave të para muzikore të krijuara gjatë kësaj periudhe, muzikën në periudhën Barok, Klasicizëm, Romantizëm dhe shekulli 20-të dhe rrymave të ndryshme moderne (xhaz, rok, etj). Gjithashtu, kjo tematikë mundëson njohjen dhe studimin me zhvillimin e muzikës shqiptare përmes jetës dhe veprave të kompozitorëve të këtyre periudhave.

Përjetimi dhe të shprehurit përmes dëgjimit muzikor është një proces shumë i rëndësishëm në muzikë, i cili nuk mund të zhvillohet pa njohur shumë mirë si u krijua dhe u zhvillua kjo lloj muzike në periudha të caktuara, ndikimet dhe karakteristikat që patën veprat muzikore nga koha në të cilën u krijuan. Karakteristikat e periudhës, veprat e kompozuar dhe kompozitorët do të vijnë thjeshtë dhe natyrshëm përmes njohurive paraprake të nxënësve, dëgjimit dhe përjetimit konkret të veprave muzikore, përmes diskutimeve dhe interpretimit të mendimit muzikor apo prezantimeve individuale dhe në grup (projekteve) të periudhave të marra në studim.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS

Krijimi muzikor

Nxënësi/ja:

- përjeton emocionalisht një vepër muzikore (vokale instrumentale) dhe krijon ese për të shprehur gjykimet e veta;

- krijon CD me pjesët më të zgjedhura e të preferuara nga vepra të ndryshme muzikore;
- krijon opinion dhe gjykimin e vet artistik duke u nisur nga karakteristikat e periudhës në të cilën u krijua vepra muzikore;
- ndan gjykimin e vet për një krijim muzikor me të tjerët.

Interpretimi muzikor

Nxënësi/ja:

- interpreton nga ana artistike dhe estetike domethënien e një vepre muzikore;
- interpreton të dhëna, fakte dhe kuriozitete për të nxjerrë në pah rëndësinë e zhvillimit të formave muzikore vokale dhe instrumentale në periudha të ndryshme.

Vlerësimi i veprave muzikore

Nxënësi/ja:

- bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi muzikën dhe asaj që studion, duke ndarë informacionet që mbart;
- bën gjykime kritike ndaj një vepre muzikore vokale apo instrumentale duke u mbështetur në *elementet muzikore, formën dhe karakterin* e pjesëve muzikore;
- komunikon dhe shpreh përjetimin e vet emocional, rreth veprave muzikore të dëgjuara sipas karakteristikave *historike, politike, gjeografike, kulturore, fetare* që ndikuan në zhvillimin e kulturës muzikore në periudha të ndryshme;
- ndan përvojën/mendimin e vet artistik me të tjerët dhe respekton mendimin e shokëve;
- prezanton punën e vet përmes mediave dhe teknologjive të ndryshme;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme kulturore brenda dhe jashtë shkollës.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Kultura muzikore dhe zhvillimi i saj, sipas karakteristikave të periudhës, veprave dhe kompozitorëve:

- Kultura muzikore në Antikitët.
- Muzika në Mesjetë.
- Muzika në periudhën e Rilindjes.
- Muzika në periudhën Barok.
- Muzika në periudhën e Klasicizmit.
- Muzika në periudhën e Romantizmit.
- Zhvillimi i muzikës në shek XX.
- Muzika moderne dhe rryma të ndryshme.
- Muzika shqiptare.

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA X

Nxënësi/ja:

- kërkon dhe analizon rrugën që ka ndjekur zhvillimi i kulturës muzikore në periudha të ndryshme;
- shpjegon karakteristikat *historike, politike, gjeografike, kulturore, fetare* që ndikuan në zhvillimin e kulturës muzikore në periudha të ndryshme;
- kërkon të dhëna dhe krahason dy vepra të të njëjtës formë muzikore me autorë të ndryshëm, duke argumentuar veçoritë e veprës vet;
- përzgjedh dy *forma muzikore*, vokale apo instrumentale dhe shpjegon karakteristikat dhe veçoritë e tyre;
- vlerëson veprat muzikore, sipas *llojit, autorit, vendit dhe periudhës historike* në të cilën është realizuar vepra, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik;
- shpreh nëpërmjet *ese-së* emocionet që i krijon vepra muzikore;
- prezanton informacionin e mbledhur rreth zhvillimit muzikor për çështje specifike gjatë këtyre periudhave të marra në studim, në *ppt*;
- realizon një *projekt ndërlëndor*, mbi jetën dhe veprën e një kompozitori apo grupi kompozitorësh të një periudhe të caktuar;
- krijon CD me pjesët më të zgjedhura e të preferuara nga vepra të ndryshme muzikore klasike apo moderne;
- përdor mjete të ndryshme të teknologjisë për: *kërkim të dhënash*,

prezantim, regjistrime audio dhe video.

Qëndrime dhe vlera

Nxënësi /ja:

- dëgjon dhe shpreh mendimin e vet të bazuar në njohuritë muzikore mbi format dhe llojet muzikore;
- shpjegon emocionin e krijuar nga dëgjimi i veprave muzikore përmes përjetimit të tyre konkret;
- shpreh idetë e veta për muzikën që dëgjon;
- komunikon dhe shprehet artistikisht për një pjesë muzikore;
- demonstroi vetëbesim në aktivitete të ndryshme muzikore/artistike;
- komunikon në mënyrë të pavarur, duke argumentuar qartazi mendimin e vet;
- merr pjesë aktive në veprimtaritë muzikore vetëm dhe në grup;
- përdor imagjinatën për të krijuar ose interpretuar mendimin mbi muzikën dhe veprat muzikore;
- krijon vetëbesim gjatë prezantimit të punëve të veta;
- bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari muzikore/projekt të përbashkët;
- respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme muzikore që dëgjon, përjeton apo njih;
- respekton krijimet e veta dhe të tjerëve;
- zhvillon një gjykim të saktë ndaj veprave të ndryshme muzikore që dëgjon, pavarësisht karakteristikave *historike, politike, gjeografike, kulturore, fetare* që ndikuan në zhvillimin e kulturës muzikore në periudha të ndryshme;
- performon duke demonstruar njohje shumë të mirë të kulturës kombëtare apo të kulturave të tjera;
- zhvillon frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë proceseve të ndryshme artistike;
- përqëndrohet dhe tregon durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

IV. Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve të muzikës është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor/artistik që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të muzikës, do të thotë që nxënësi të vendoset *në situata konkrete krijuese*, ku përjeton dhe provon vetë gjatë proceseve muzikore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet motivimit dhe përkundrejt zhvillimit të kompetencave të caktuara si dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e muzikës, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore është e pëlqyeshme dhe krijon emocione kur nxënësit drejtohen drejt saj në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/krijues dhe artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia e muzikës synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet *në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.*

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e muzikës mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënësve në muzikë;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- vazhdimin e formimit dhe forcimin e aftësive dhe shprehive muzikore;
- rëndësinë e zbatimeve krijuese/interpretuese/vlerësuese muzikore, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet muzikore me situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve muzikore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë CD, DVD, kompjuter, magnetofon;
- veçoritë e interpretimit në mënyrë individuale dhe në grup;

- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së muzikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi të jenë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e planifikuar mirë krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat muzikore të përcaktuara në këtë program janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, krijime ose simulime të njohurive, interpretime/performime, gjykime dhe qëndrime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë.

Gjithashtu është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsytetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si “Pse më pëlqen?”, “A është melodioze?”, “Cilat instrumente dëgjoj?” “Pse shquhet ky kompozitor ?” etj.

Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të zhvillojë situata të reja.

Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, arrin të krijojë lidhje integrale me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave muzikore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive muzikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*p.sh.*

vetëvlerësimi, interpretimi i një liste këngësh për të rinj, portofoli me punë muzikore, prezantimi me gojë ose ppt i kompozitorëve të ndryshëm).

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Muzika, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e krijimit individual, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirjet e veta të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale. *Inkurajimi, imagjinata muzikore, shprehja origjinale dhe krijuese, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve muzikore janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në muzikë dhe arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale, por edhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve dhe objekt i vlerësimit janë puna për formimin e kompetencave muzikore të nxënësve, që ai/ajo të jetë në gjendje të krijojë, performojë/interpretojë dhe vlerësojë saktë dhe bukur muzikën. Arritjet në fushën e muzikës dhe të arteve janë më shumë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla. Ky vlerësim bëhet përmes *vlerësimit të vazhdueshëm, vlerësimit me detyra përmbledhëse dhe vlerësimit të dosjes së nxënësve.*

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave muzikore, që arrin të zhvillojë dhe demonstrojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes *të kënduarit, të dëgjuarit muzikor, të krijuarit, të analizuarit të pjesëve artistike* etj.

Portofoli i nxënësve, është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në muzikë. Ai mund të përmbajë krijime, projekte kurrikulare, prodhime të ndryshme të CD-ve e DVD-ve në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, etj.

Vlerësimi i nxënësve në shkallën e pestë bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

VI. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mëimit të muzikës, për realizimin e kompetencave, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitetet. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësin të gjejë këngë

me tematikë të ndryshme, për të rinj, arie, mjuzikëll, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës.

Tekstet dhe materialet sigurojnë një qasje përmes përdorimit të tyre të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të medieve, detyrave dhe projekteve të ndryshme, u krijohet mundësia nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh.: për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve muzikore, këngëve, përdoren magnetofoni, TV, CD dhe DVD.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet audiovizive si:* TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet dëgjimore:* magnetofon, etj.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën.

Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në realizimin e krijimeve të ndryshme.

- *Mjedisi mësimor si:* klasa, kabinetet e arteve /muzikës etj..